



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.04.2022)*

*Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:05 dhe mbaroi në orën 12:55.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i>       | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>3. Fatmira Luli</i>    | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>4. Irena Plaku</i>     | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>6. Ridvan Hado</i>     | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>7. Alban Toro</i>      | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>8. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>9. Marçela Shehu</i>   | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>10. Yllka Rupa</i>     | <i>(anëtare)</i>         |

*Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

*1. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

*2. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*

*3. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

*4. Valbona Bako, Përgjegjëse pranë Sektorit të përgatitjes së dokumentacionit dhe përfaqësimit në gjykatë.*

*5. Staf administrativ i KLGJ-së.*

## **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).<sup>1</sup>

Në pamundësi për të drejtuar mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbledhja drejtohet nga Zëvendëskryetari i Këshillit.

Çështja e cila është për trajtim sot në rendin e ditës lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Zoti Kurushi fillimisht relaton shkurtimisht relacionin sa i përket radhës së shortit duke i propozuar Këshillit që procedurat e shortit të ndiqen sipas kësaj radhe:

Gjykatat e shkallës së parë, sipas kësaj radhe:

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Gjykatat e apeleve, sipas kësaj radhe:

Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm: Gjykata e Apelit Korçë; Gjykata e Apelit Gjirokastrë; Gjykata e Apelit Vlorë.

---

<sup>1</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Pasi anëtarët janë dakord me radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion). Këto dy çështje janë në një procedim të lidhur dhe prandaj 3 gjyqtarët që do të caktohen për një të çështje, nuk mund të caktohen edhe për çështjen e dytë pasi kanë shkak papajtueshmërie për të gjykuar edhe çështjen e dytë.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 6 (gjashtë).

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart, të cilët janë në përbërje të Kolegjit Zgjedhor, që është thirrur në detyrë, referuar nenit 149/2 të

Kodit Zgjedhor, konkretisht: {...}, {...}, {...} (kjo pasi, Komisioni ka dërguar një shkresë Gjykatës së Apelit Administrativ me qëllim që të merrej informacion nëse gjyqtarët e përfshirë në Kolegjin Zgjedhor kanë pushuar funksionet e tyre për vijimin e gjykimeve me natyrë administrative për zgjedhjen e fundit, dhe deri në këto momente nuk është marrë ende një përgjigje).

Bashkëlidhur relacionin gjendet edhe lista me gjyqtarë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të cilët plotësojnë kriteret ligjore të përmendura më sipër (12 gjyqtarë; ndërsa brenda këtij numri gjyqtarësh ka shkaqe papajtueshmërie si: z. {...} që ka pengesë ligjore pasi ka qenë në një proces tjetër ligjor të lidhur me këto çështje; znj. {...} që së shpejti mund të ngrihet në detyrë, pasi kur bëhet fjalë për gjykime, duke iu referuar objektit që është parashtruar nga zëvendëskryetarja e gjykatës së shkallës së parë, nëse do të binte në short kësaj gjyqtareje, Komisioni mendon që ajo mund ta lërë trupin gjykues me dy gjyqtarë për shkak të promovimit të saj që së shpejti mund t'i bëhet nga Këshilli; z. {...} ka pengesë ligjore; znj. {...} ka pengesë ligjore).

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Diamela Goxha (relatore), Migena Laska dhe Sokol Pina (anëtarë).

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Rexhep Bektashi (relator), Arbana Selmanaj dhe Maltida Llangozi (anëtarë).

Vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë** ka paraqitur nevojë për 5 çështje gjyqësore, 2 në lëndë penale dhe 3 në lëndë civile (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të

KLGGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 5 (pesë) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, seksioni penal dhe ai civil.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 5 (pesë) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3 (tre).

Për 2 (dy) çështje, për të cilat kërkohen nga 1 (një) dhe 2 (dy) gjyqtarë, të përzgjidhen 2 (dy) të tillë me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, seksioni penal.

Për 3 (tre) çështje, për të cilat kërkohet nga 1 (një) gjyqtar, të përzgjidhet 1 (një) i tillë me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, seksioni civil.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjeve, të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, konkretisht: Z. Sokol Shehu.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtari i seksionit civil, {...}, të cilit me vendimin nr. 121, datë 29.03.2022 të Këshillit i është miratuar kërkesa për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit me pagesë, për periudhën 04.04.2022-01.07.2022.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Arbër Çela dhe Hasan Selimi.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Hasan Selimi.

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtarja {...}.

Për çështjen nr. 4, civile, gjyqtarja {...}.

Për çështjen nr. 5, civile, gjyqtarja {...}.

*(Duke qene se nga informacionet, znj. {...} është e shkarkuar me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe një gjë e tillë nuk ishte e pasqyruar në sistemin*

*elektronik të shortit, anëtarët e Këshillit vendosin që shorti të ripërsëritet duke e përjashtuar zonjën {...}, pasi ajo rezulton e pezulluar me vendim të KPK-së.)*

Rihidhen edhe një herë në short çështjet civile sipas tabelës në relacion.

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtarja Izabela Radovani.

Për çështjen nr. 4, civile, gjyqtarja Izabela Radovani.

Për çështjen nr. 5, civile, gjyqtarja Izabela Radovani.

Vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht të ulët dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, të mos përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e kësaj gjykate, konkretisht: Znj. Enkeleda Dalipi.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1 dhe nr. 2, penale, gjyqtari Aulon Pashaj.

Vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë** ka paraqitur nevojë për 4 çështje gjyqësore, 1 në lëndë penale dhe 3 në lëndë civile (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 4 (katër) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 (katër) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, konkretisht: Z. Paulin Çera.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1 (penale) dhe nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4 (civile), gjyqtarja Shpëtime Pitaku.

Vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, 1 në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastër, përfshirë edhe gjyqtarin e skemës së delegimit.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 3 (tre).

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, konkretisht: Z. Dritan Banushi.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Irena Brahimi (relatore), Sokol Pina dhe Miranda Andoni.

Vijohet me relatimin e relacionit të gjashtë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastër”.



Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, 1 në lëndë civile (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Vlorë, përfshirë dhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti Kryetarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, konkretisht: Znj. Iliba Bezati.

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtari {...}, i cili me vendimin e Këshillit nr. 137, datë 06.04.2022 u rendit i pari për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 30, datë 25.01.2021 dhe së shpejti mendohet që mund të ngrihet në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtari Sokol Ngresi.

Vijohet me relatimin e relacionit të fundit “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, 1 në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Kërkesat e mësipërme të Gjykatës së Apelit Vlorë janë bërë në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor ende nuk kishte marrë Vendimin nr.597, datë 23.12.2021, “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Vlorë, z. {...}”. Në vijim, Gjykata e Apelit Vlorë me shkresën nr. {...} prot., datë 18.03.2022 ka bërë me dije se “...në kushtet kur pranë Gjykatës së Apelit Vlorë është emëruar gjyqtar {...} dhe trupi gjykues mund të plotësohet me këtë gjyqtar, kërkojmë mosmarrjen në shqyrtim nga ana juaj të kërkesave për të cilat kemi kërkuar delegim për një gjyqtar, bashkëlidhur dhe kërkesa sipas të dhënave të mësipërme.”.

Për rrjedhojë, nevoja për kërkesën si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë, aktualisht nuk ekziston më, pasi nevoja për caktimin e 1 (një) gjyqtari në çështjen konkrete është plotësuar përmes pjesëmarrjes në këtë gjykim të gjyqtarit {...}.

Në këto kushte, kërkesa si më lart e Gjykatës së Apelit Vlorë tashmë ka mbetur pa objekt, është vendi që Këshilli të vendosë për deklarin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, rregullimet e të cilit duhet të zbatohen nga Këshilli në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sikurse përcakton neni 97/3 i tij.

Sipas nenit 90/3 të Kodit të Procedurave Administrative, “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Ndërsa sipas nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, parashikon se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

Kurse sipas nenit 97/3 të Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, parashikon se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e

Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj”.

Nisur nga rrethanat si më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Apelit Vlorë si vijon:

Kërkesës nr. {...} prot., datë 30.12.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore nr. {...} regj., datë 18.10.2018, me kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, të pandehur: {...}, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”.

*(Për shkaqe teknike, audio dhe relatimi nga zotit Kurushi ndërpritet, gjithashtu shkëputen nga platforma të gjithë të pranishmit “online”. Pas disa minutash rimundësohet lidhja në platformë dhe mbledhja rifillon sërish.*

*Relatohet edhe një herë nga e para relacioni “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”. Për të mos u përsëritur, pjesa e parë e relacionit që u parashtrua më herët gjendet e zbardhur më sipër.)*

Propozimi i Komisioni për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Apelit Vlorë me nr. {...} prot., datë 30.12.2021 hidhet në votim. Ky propozim votohet nga të gjithë anëtarët prezent në mbledhje dhe miratohet me unanimitet.

Vijon pjesa e dytë të relatimit më poshtë:

Ndërsa, lidhur me çështjen tjetër, Gjykata e Apelit Vlorë me shkresën nr. 34 prot., datë 31.03.2022 ka bërë me dije se “...në kushtet kur pranë Gjykatës së Apelit Vlorë është emëruar gjyqtar {...} dhe trupi gjykues mund të plotësohet me këtë gjyqtar, kërkojmë mosmarrjen në shqyrtim të kërkesës nr. {...} prot., datë 10.11.2021 për dy gjyqtarë të deleguar dhe vazhdimin e kërkesës vetëm për delegimin e një gjyqtari.”.

Ndaj, për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë, për kërkesën me numër rendor 2, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit

për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastrë, përfshirë dhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, konkretisht: Z. Dritan Banushi.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Miranda Andoni.

Me kaq mbyllet procedurat e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**